

Instituti për Studime të Avancuara GAP

## Letërnjoftimi i Komunës së Skenderajt 2013

Mars, 2013

*“Letërnjoftimi i Komunave”* është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale tri vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”. Thirrjes për debat nuk i është përgjigjur vetëm Komuna e Skenderajt.

## Përmbajtja

|   |    |
|---|----|
| Përmbledhje ekzekutive .....                                | 3  |
| 1. Hyrje .....  | 4  |
| 2. Problemet në Komunën e Skenderajt.....                   | 5  |
| 3. Performanca buxhetore e Komunës së Skenderajt.....       | 6  |
| 4. Investimet kapitale .....                                | 11 |
| 5. Aktivitetet e Prokurimit Publik .....                    | 14 |
| 6. Administrata e Komunës së Skenderajt .....               | 15 |
| 7. Arsimi në Komunën e Skenderajt .....                     | 16 |
| 8. Shëndetësia në Komunën e Skenderajt.....                 | 18 |
| 9. Transparenca e Komunës së Skenderajt.....                | 19 |
| 10. Përbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009 ..... | 21 |
| 11. Burimet.....  | 26 |

## Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Skenderajt, e cila që nga koha e pas luftës udhëhiqet nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në vitin e fundit (2012) ka pasur rënien më të madhe të hyrave komunale. Gjatë vitit 2012, Komuna e Skenderajt ka mbledhur 572.000 euro, përderisa një vit më herët (2011) shuma e të hyrave komunale ka qenë mbi 1.2 milionë euro apo rreth 52% më shumë se në 2012.

Krahas rënies së të hyrave, Komuna e Skenderajt ka nivelin më të lartë të borxhit publik në krahasim me komunitat e tjera. Në vitin 2011 niveli i borxhit që ka pasur Skenderajt është llogaritur në mbi 3.8 milionë euro, ndërsa në vitin 2012, shuma e borxhit rezultoi të jetë mbi 1.5 milionë euro.

Rënia e të hyrave dhe shkalla e borxhit nuk është manifestuar me rënien e shpenzimeve. Sipas të dhënave zyrtare, mbi 90.000 euro janë shpenzuar në vitin 2012 për karburant për vetura, 26.000 në telefona fiks dhe mobil, ndërsa mbi 29.000 euro në dreka dhe darka zyrtare. Në përgjithësi në tri vitet e fundit (2010-2012) Komuna e Skenderajt për dreka dhe darka ka shpenzuar 110.306 euro, për telefoni mobile 39.355 euro, për telefoni fikse 39.082 euro, karburant për vetura 237.104 euro, naftë për ngrohje 143.797 euro, blerje të druve dhe thëngjillit për ngrohje 258.596 euro, karburant për gjenerator mbi 21.000 euro, ndërsa për riparim dhe mirëmbajtje të veturave zyrtare janë shpenzuar 56.971 euro.

Komuna e Skenderajt në tri vitet e fundit ka përmirësuar në mënyrë esenciale infrastrukturën e rrugëve, por mbeten të pamjaftueshme investimet në rrjetin e ujësjellësit dhe atë të kanalizimit. Edhe për kundër rritjes së shkallës së investimeve publike në këtë komunë, shkalla e varfërisë vlerësohet e lartë. Rreth 20% e popullatës së përgjithshme të Skenderajt janë në asistencë sociale.

Komuna e Skenderajt ka përfaqësim tejet të vogël të femrave në pozitat publike. Përveç që asnjë drejtori nga nëntë gjithsej, nuk udhëhiqen nga femrat, numri i femrave të punësuar në dikasteret e komunës del të jetë tejet i vogël. Kësisoj, nga 208 të punësuar si shërbyes civil, vetëm 38 prej tyre janë femra (apo vetëm 18.2%). Numri i femrave të punësuar është tejet i vogël edhe në sistemin arsimor dhe atë shëndetësor të kësaj komune.

Në këtë raport, i cili mbulon zhvillimet rreth politikave publike në Komunën e Skenderajt për periudhën janar 2010 – dhjetor 2012, Instituti GAP ka përmendur problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët, ka analizuar performancën buxhetore, investimet kapitale, aktivitetet e prokurimit publik, gjendjen në administratë, arsim dhe shëndetësi, transparencën e Komunës, si dhe ka matur realizueshmërinë e premtimeve të dhëna gjatë fushatës zgjedhore të 2009.

## 1. Hyrje

Komuna e Skenderajt udhëhiqet nga z. Sami Lushtaku, i cili pozitën e të parit të komunës e ka fituar duke përfaqësuar subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Viti 2013 paraqet vitin e fundit të përmbylljes së mandatit të dytë në pozitën e Kryetarit të Komunës. Mandatin e parë Lushtaku e ka fituar në zgjedhjet lokale të mbajtura në fund të vitit 2007. Në zgjedhjet e fundit Lushtaku fitoi 85% të votave, ndërsa i dyti pas tij më i votuari ka qenë Fadil Geci nga Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD) me rreth 11% të votave<sup>1</sup> Kryetari aktual ka paralajmëruar se nuk do të rikandidojë edhe për një mandat të ri në zgjedhjet e ardhshme.<sup>2</sup> Kryetari i Skenderajt aktualisht përballet me kallëzim penal nga Prokuroria Speciale e Kosovës për orkestrimin e një fushate kërcënuese ndaj drejtueses së emisionit “Jeta në Kosovë”.<sup>3</sup> Ai po ashtu është akuzuar edhe për kërcënim të gazetarit nga “Koha Ditore” Adem Meta.<sup>4</sup> Për këtë rast, kanë nisur hetimet ndaj Kryetarit të Skenderajt nga ana e Prokurorisë Speciale të Kosovës.<sup>5</sup>

Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, Skenderaj ka rezultuar t'i ketë 50.858 banorë<sup>6</sup>, kurse deri më tani është supozuar se në këtë komunë jetojnë mbi 72.000 banorë.<sup>7</sup> Megjithatë, Skenderaj ka marrë grant nga niveli qendror për 56.000 banorë, që i bje se shifra e supozuar për grante dhe shifrat e regjistrimit të popullsisë të rasti i Skenderajt nuk kanë ndonjë dallim të madh.<sup>8</sup>

Ekzekutivi i Komunës së Skenderajt përbëhet nga nëntë Drejtori. Asnjë Drejtori nuk udhëhiqet nga femrat.

Në Kuvendin Komunal shumicën absolute të ulëseve e përbëjnë kuvendarët e PDK-së. Nga gjithsej 28 vende sa ka Kuvendi i Skenderajt, 23 prej tyre i takojnë PDK, tre LDD, një AKR dhe një vend i takon LDK.

---

<sup>1</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultatet e zgjedhjeve për Kryetar të Komunave. 2009. Fq 22. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/kryetar/results%20by%20municipality%20.pdf>

<sup>2</sup>Televizioni “Kohavizion”. Emisioni “Rubikon”. Intervistë më Kryetarin e Komunës së Skenderajt Sami Lushtaku. Data: 26.06.2012. Burimi: <http://www.kohavision.net/video/rubikon/4322/>

<sup>3</sup>Buletini “Drejtësia në Kosovë”. Burimi: <http://drejtesianekosove.com/sq/Buletini-11/3-Ngritet-aktakuze-ndaj-Sami-lushtakut-dhe-Rexhep-Hotit-1385>

<sup>4</sup>Asociacioni i Gazetareve Profesionist të Kosovës. Kumtesë për media. Data: 27.09.2012. Burimi <http://www.kohaditore.com/?page=1,13,116856>

<sup>5</sup>Agjencia e Lajmeve “Kosovaitimes”. Datë: 04.10.2012. Burimi: <http://www.kosovaitimes.net/?page=1,3,16204>

<sup>6</sup>Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: [http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)

<sup>7</sup>Ueb faqja zyrtare e Komunës së Skenderajt. Gjeografia dhe demografia e Komunës. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/skenderaj/City-guide/Geography.aspx>

<sup>8</sup>Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L049\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf)

## 2. Problemet në Komunën e Skenderajt

Përveç problemeve të përgjithshme që nuk lidhen me përgjegjësitë direkte të komunave, si papunësia, varfëria, mungesa e rrymës, banorët e Komunës së Skenderajt përballen edhe me probleme si mungesa e kanalizimeve, rrjetit të ujësjellësit, mungesë të shërbimeve shëndetësore, ndotja e lumit të qytetit, mungesa e mirëmbajtjes nëpër ndërtesa publike si dhe në disa raste është hasur dukuria e dëmtimit të shpejtë infrastrukturës rrugore nga cilësia e dobët e punimeve të kryera.

Territori i Komunës së Skenderajt numëron 51 fshatra.<sup>9</sup> Nga ky numër i fshatrave vetëm dy prej tyre janë të lidhura me rrjetin e kanalizimit, përkatësisht fshati Prekaz i Epërm dhe fshati Klinë e Poshtme. Gjendja e përafërt qëndron edhe me rrjetin e ujësjellësit. Afërsisht 15 fshatra llogariten të jenë të lidhur në ujësjellësin e qytetit. Fshatrat tjera shfrytëzojnë alternativa të ndryshme për ujë të pijes si dhe për kanalizim. Përpjekjet e autoriteteve komunale në këtë drejtim janë fokusuar në gjetjen e donacioneve për të investuar në shtrimin e rrjetit të kanalizimit dhe atë të ujësjellësit, por mungesa e donacioneve ka pamundësuar investimet në këtë sferë. Mungesa e ujit të pijes dhe për ujitje tokash në fshatrat e Skenderajt është zbutur nga vetë investimet e familjeve të atyre zonave duke hapur puse, por gjendja mbetet e keqe nga mungesa e kanalizimeve. Derdhja e tyre vend e pa vend ka ndikuar në ndotjen e ambientit, duke kundërmuar kohë pas kohe dhe duke rritur, veçmas gjatë verës, prezencën e insekteve.

Edhe lumi "Klina" që përshkon qytetin shfrytëzohet nga zonat e ndryshme të qytetit dhe fshatrave përreth për derdhjen e kanalizimeve dhe ujërave të zeza. Komuna në tri vitet e fundit ka investuar në rregullimin e lumit në mbi 1000 metra gjatësi, duke vendosur gur dhe duke gjelbëruar dhe rregulluar zonën përreth. Mirëmbajtja e lumit nga ana e autoriteteve është vërejtur vetëm në këtë pjesë të rregulluar, por jo edhe në zonat tjera ku kalon lumi. Hedhja e mbeturinave dhe derdhja e kanalizimeve, sidomos gjatë kohës së verës, shkakton kontaminim të ambientit.

Një problem tjetër më të cilin përballën qytetarët e Komunës së Skenderajt është pamundësia e qendrave mjekësore për të ofruar shërbime në disa kategori. Kësisoj, QKMF në qendër të qytetit po hynë në vitin e tretë që nuk ofron shërbimin e stomatologjisë në mungesë të stomatologëve. Disa shërbime tjera kanë staf adekuat, por mungojnë pajisjet e nevojshme dhe kësisoj shërbimet nuk mund të ofrohen. Kjo gjendje po i shtynë qytetarët e kësaj komune t'u drejtohen ordinancave private, ndonëse kapacitetet ekonomike të tyre janë tejet të kufizuara.

Komuna e Skenderajt në tri vitet e fundit nuk ka organizuar dhe financuar transportin e bartjes së nxënësve dhe mësimdhënësve në relacionet ku distanca mes shtëpive dhe shkollave është më e madhe se katër kilometra. Ky obligim ligjor i komunës është i

---

<sup>9</sup>Kuvendi i Kosovës. Ligji për Ndarjen e kufijve Administrativ të Komunave. Nr.03/L-041. Fq 27. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L041\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L041_al.pdf)

paraparë në Ligjin për Shkollimin Para Universitar.<sup>10</sup> Kësisoj nxënësit e fshatit Kotorr të Skenderajt udhëtojnë për çdo ditë mbi tetë kilometra në një drejtim për të shkuar në shkollë. Ngjashëm qëndron gjendja edhe me disa fshatra tjera të kësaj komune. Përderisa nxënësit e fshatit Kotorr udhëtojnë në atë distancë për të shkuar në shkollë, në fshatin Kastriot tash e katër vite shkolla e ndërtuar nuk është funksionale me arsyetimin e mungesës së nxënësve. Kjo nxjerrë në pah planifikimin jo të mirë në ndërtimin e shkollave, ngase mungesa e nxënësve do të duhej evidentuar para fillimit të ndërtimit të shkollës dhe jo pas ndërtimit të saj.

Në tri vitet e fundit shuma e investimeve kapitale ka qenë e gjerë në Komunën e Skenderajt dhe këto investime janë koncentruar kryesisht në rregullimin, zgjerimin dhe asfaltimin e rrugëve urbane dhe atyre rurale. Cilësia e punimeve të kryera në disa raste ka qenë tejet e dobët. Shembull për këtë është marrë rruga për në fshatin Aqarevë e cila pak muaj pas inaugurimit është dëmtuar. Njësoj është gjendja në rrugën për fshatin Izbicë.

### 3. Performanca buxhetore e Komunës së Skenderajt

Komuna e Skenderajt në tri vitet e fundit (2010 – 2012) është futur në borxhe të mëdha, ku sipas raporteve zyrtare të Komunës së Skenderajt, mbi 1.5 milionë euro konsiderohet shkalla e borxhit që ka kjo komunë ndaj operatorëve privat më të cilët ka kontraktuar punë publike. Raportet e Ministrisë së Financave të Qeverisë së Kosovës për vitin 2011 e llogarisin borxhin e Komunës së Skenderajt në mbi 3.8 milionë euro.<sup>11</sup> Kjo nxjerr në pah shpenzimet e pakontrolluara në këtë komunë, përkatësisht kontraktimin e punëve pa pasur mbulesë financiare. Nëse kjo praktikë nuk ndërpritet, atëherë rrezikohet që në vitet në vijim e gjithë qarkorja buxhetore për investime kapitale, mallra dhe shërbime si dhe për subvencione të dedikohet për larje borxhesh.

Krahas kësaj, të hyrat komunale në Skenderaj në vitin e fundit (2012) kanë shënuar rënie për mbi 640.000 euro.<sup>12</sup> Rënia e të hyrave, bashkë me nivelin e lartë të borxhit, janë dy indikatorë që tregojnë për gjendjen jo të mirë financiare në të cilën ndodhet Komuna e Skenderajt.

Shpalosjen e obligimeve të pashlyera financiare ndaj operatorëve privat dhe ndërmarrjeve publike nga ana e Komunës së Skenderajt, e ka prezantuar edhe raporti i

---

<sup>10</sup>Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Ligji për Shkollimin Para Universitar në Republikën e Kosovës. Nr. 04/L-03. Neni 15. Pika 5.1. Fq 13. Burimi: [http://www.masht.gov.net/advCms/documents/1\\_Ligji\\_per\\_arsimin\\_Parauniversitar.pdf](http://www.masht.gov.net/advCms/documents/1_Ligji_per_arsimin_Parauniversitar.pdf)

<sup>11</sup>Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Tabelat e Buxhetit të Kosovës për vitin 2011. Burimi: <http://mf.rks-gov.net/sqal/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxhetiendrore.aspx>

<sup>12</sup>Komuna e Skenderajt. Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim. Tabelat e Buxhetit për vitin 2012. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/skenderaj/Municipality/Departments/Finance,-Economy-and-Development/Raportet/Raportet-2012.aspx>

Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011. Këto borxhe lidhen me mos pagimin e rrymës, telefonit, mbeturinave, derivateve për gjenerator, furnizim për zyre, karburant për vetura, riparim dhe mirëmbajtje të veturave zyrtare si dhe për investime kapitale.<sup>13</sup>

Tabela: nr.1: Borxhi i Komunës së Skenderajt 2009-2012

| Viti                | 2012 <sup>14</sup> | 2011      | 2010   | 2009 |
|---------------------|--------------------|-----------|--------|------|
| <b>Shuma (euro)</b> | 1.503.106          | 3.818.948 | 21.851 | 0    |

Komuna e Skenderajt gjatë vitit 2010 dhe atij 2011 shënoi progres në vjeljen e të hyrave dhe rritjen e shkalles financiare në linjën e të hyrave komunale. Por, në 2012 kjo komunë ka shënuar rënie drastike të hyrash, gjë kjo e cila do të reflektojë në pamundësinë e autoriteteve komunale në përmbushjen e prioriteteve të parapara nga lista e investimeve kapitale.

Tabela: nr.2: Të hyrat komunale në katër vitet e fundit në Komunën e Skenderajt<sup>15</sup>

| Viti                | 2012    | 2011      | 2010      | 2009    |
|---------------------|---------|-----------|-----------|---------|
| <b>Shuma (euro)</b> | 572.000 | 1.213.452 | 1.023.355 | 564.100 |

Tabela: nr.3: Të hyrat komunale gjatë vitit 2012 sipas sektorëve dhe krahasimi i tyre me vitin 2011

| Linja e të hyrave                     | Shuma (euro) |         |                   |
|---------------------------------------|--------------|---------|-------------------|
|                                       | 2012         | 2011    | Diferenca (- & +) |
| Tatimi në pronë                       | 117.000      | 138.000 | -21.000           |
| Participimi në shëndetësi             | 16.000       | 19.000  | -3.000            |
| Taksa për leje ndërtimi               | 62.000       | 653.000 | -591.000          |
| Taksa ndaj biznesit                   | 64.000       | 89.000  | -25.000           |
| Taksë për regjistrimin e automjeteve  | 56.000       | 63.000  | -7.000            |
| Taksa për shërbimet në ofiqari        | 25.000       | 26.000  | -1.000            |
| Taksë për ndërrimin e pronës          | 00           | 11.000  | -11.000           |
| Taksë për regjistrimin e trashëgimisë | 22.000       | 25.000  | -3.000            |
| Taksë për certifikata të lindjes      | 28.000       | 23.000  | +5.000            |
| Nga shfrytëzimi i pronës publike      | 23.000       | 13.000  | +10.000           |

<sup>13</sup>Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Skenderajt për vitin 2011. Pjesa e dytë. Raporti Financiar i Komunës së Skenderajt. Fq 16 - 30. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/Skenderaj\\_ALB\\_179857.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Skenderaj_ALB_179857.pdf)

<sup>14</sup>Në bazë të dokumenteve zyrtare nuk sqarohet nëse shuma e borxhit të 2012 është totali i obligimeve të pashlyera financiare që ka Komuna e Skenderajt në tri vitet e fundit apo niveli i borxhit prej 1.503.106 euro lidhet vetëm me vitin 2012, pa përfshirë edhe shumën e borxhit të një viti me herët 2011.

<sup>15</sup>Komuna e Skenderajt. Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim. Raporti Financiar për periudhën janar - dhjetor 2012. Fq 13.

|                                  |                |                  |                  |
|----------------------------------|----------------|------------------|------------------|
| Të hyrat nga sektori i arsimit   | 21.000         | 20.000           | +1.000           |
| Të hyrat nga inspekcioni         | 10.000         | 10.000           | 00               |
| Taksa nga shërbimi i kurorëzimit | 10.000         | 9.000            | +1.000           |
| Pranimi teknik i lokaleve        | 1.000          | 5.000            | -4.000           |
| Taksa administrative             | 21.000         | 5.000            | +16.000          |
| Taksë për pjesëmarrje në tender  | 00             | 3.000            | -3.000           |
| Gjoha nga inspekcioni            | 1.000          | 3.000            | - 2.000          |
| Qiraja nga objektet publike      | 10.000         | 1.000            | +9.000           |
| Të hyrat nga gjobat ne trafik    | 17.000         | 24.000           | -7.000           |
| Të hyra nga koncesioni           | 00             | 31.000           | -31.000          |
| Të hyra nga gjobat nga gjykatat  | 68.000         | 42.000           | +26.000          |
| <b>Gjithsej</b>                  | <b>572.000</b> | <b>1.213.000</b> | <b>- 641.000</b> |

Nga tabela e mësipërme mund të konstatohet se faktori i cili ka ndikuar më së shumti në rënien e të hyrave komunale është mungesa e aplikimit të taksës për leje ndërtimi. Nga kjo taksë, Komuna e Skenderajt në vitin 2011, ka mbledhur të hyra 653.000 euro, përderisa në vitin 2012 janë mbledhur vetëm 62.000 euro. Rënie të hyrash gjatë 2012 ka pasur edhe në shumicën e linjave tjera, si nga tatimi në pronë, nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit, nga taksa për regjistrimin e veturave.

Komuna e Skenderajt gjatë një viti ka në dispozicion buxhet prej afro 10 milionë euro. Nga kjo shumë rreth 600.000 euro janë të hyra vetanake, ndërsa pjesa tjetër e buxhetit përbehet nga granti i Qeverisë së Kosovës për komuna, nga granti specifik për arsim dhe shëndetësi si dhe nga qarkorja e programuar për paga.

Tabela nr.4: Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Skenderajt 2011-2013

| <b>Kategoria</b>         | <b>2013</b>      | <b>2012</b>      | <b>2011</b>      |
|--------------------------|------------------|------------------|------------------|
| Investime Kapitale       | 2.654.902        | 2.895.902        | 2.087.168        |
| Mallra dhe shërbime      | 904.918          | 767.460          | 706.860          |
| Subvencion dhe transfere | 172.000          | 110.000          | 104.168          |
| Shpenzime komunale       | 188.776          | 144.560          | 157.892          |
| Paga                     | 6.063.732        | 5.923.547        | 5.861.539        |
| <b>Gjithsej</b>          | <b>9.984.328</b> | <b>9.841.469</b> | <b>8.917.627</b> |

Nga të dhënat e mësipërme shihet se Komuna e Skenderajt për një vit për linjën mallra dhe shërbime ka në dispozicion mbi 900.000 euro. Krahasimi mes viteve nga tabela e mësipërme nxjerr në pah se buxheti i Komunës së Skenderajt ka ardhur duke u rritur në linjën për mallra dhe shërbime, përderisa ka pësuar rënie në kategorinë e investimeve kapitale. Aktualisht Komuna e Skenderajt ka më shumë të holla të alokuara në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve se sa shuma e përgjithshme e të hyrave komunale të realizuara gjatë vitit 2012.



Tabela nr.5: Krahasimi i shpenzimeve në linjën për mallra dhe shërbime 2010-2012

| Kategoria                              | 2010    | 2011    | 2012    | Gjithsej       |
|--|---------|---------|---------|----------------|
| Dreka Zyrtare                          | 39.163  | 42.143  | 29.000  | <b>110.306</b> |
| Telefoni mobile                        | 11.617  | 14.738  | 13.000  | <b>39.355</b>  |
| Telefoni fikse                         | 15.048  | 11.034  | 13.000  | <b>39.082</b>  |
| Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit   | 8.332   | 3.371   | 10.000  | <b>21.703</b>  |
| Mëditje për udhëtime jashtë vendit     | 1.700   | 1.962   | 7.000   | <b>10.662</b>  |
| Shpenzimet kontraktuese të tjera       | 177.676 | 164.364 | 138.000 | <b>480.040</b> |
| Shpenzime - naftë për ngrohje          | 45.081  | 50.716  | 48.000  | <b>143.797</b> |
| Blerja e druve                         | 47.258  | 66.984  | 84.000  | <b>198.242</b> |
| Blerja e thëngjillit                   | 16.461  | 19.893  | 24.000  | <b>60.354</b>  |
| Shpenzime në derivate për gjenerator   | 7.195   | 5.009   | 9.000   | <b>21.204</b>  |
| Shpenzime për karburant për vetura     | 65.251  | 81.853  | 90.000  | <b>237.104</b> |
| Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve | 31.119  | 21.852  | 4.000   | <b>56.971</b>  |
| Mirëmbajtja e rrugëve                  | 4.617   | 4.360   | 14.000  | <b>22.977</b>  |
| Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve   | 30.063  | 22.895  | 30.000  | <b>82.958</b>  |

Nga të dhënat zyrtare rezulton se krahasimi i shpenzimeve mes vitit 2011 dhe atij 2010 ka rritje të theksuar shpenzimesh në disa kategori. Kështu, rritje të shpenzimeve janë hasur në kategorinë e darkave dhe drekave zyrtare, në karburant për vetura, në kategorinë e naftës për ngrohje, në blerjen e druve për ngrohje, dhe në shfrytëzimin e telefonit mobil.

Kategoria e mallrave dhe shërbimeve gjatë vitit 2012 ka shënuar rritje në disa kategori.<sup>16</sup> Veçmas rritje ka shënuar kategoria e udhëtimeve dhe mëditjeve jashtë vendit, kategoria e blerjes së druve për ngrohje, kategoria e shpenzimit të derivateve për vetura zyrtare si dhe kategoria e shpenzimit të naftës për gjenerator.

Në linjën për shpenzimet komunale ka pasur rënie të lehtë shpenzimesh gjatë vitit 2012, veçmas në pagesat për shfrytëzimin e ujit dhe shërbimin e mbeturinave.

Tabela nr.6: Prezantimi i shpenzimeve në linjën e shpenzimeve komunale për vitin 2012 dhe krahasimi me vitin 2011 dhe 2010

| Kategoria                     | 2012    | 2011   | 2010   |
|-------------------------------|---------|--------|--------|
| Pagesat për energji elektrike | 108.112 | 87.215 | 80.123 |
| Pagesat për ujë               | 29.300  | 32.001 | 31.447 |
| Pagesat për mbeturina         | 23.100  | 26.270 | 28.147 |


Nga të dhënat e mësipërme rezulton se Komuna e Skenderajt ka shpenzime të kufizuara dhe të arsyeshme në disa kategori, siç është kategoria e shpenzimeve në telefon si dhe në udhëtime dhe mëditje. Por, në disa kategori tjera niveli i shpenzimeve

<sup>16</sup>Prezantimi i shifrave fikse në tabelën nr.8 ka ardhur duke iu referuar raportit zyrtar të Komunës së Skenderajt për periudhën janar - dhjetor 2012.

është i lartë. Për tri vite për karburant për vetura janë shpenzuar mbi 237.000 euro. Nëse kësaj shifre ia bashkëngjisim edhe shpenzimet e karburantit për gjenerator si dhe naftë për ngrohje del që për tri vite janë shpenzuar mbi 402.000 euro. Komunës së Skenderajt më shtrenjtë rezultojnë kushtojnë mirëmbajtja e automjeteve se sa mirëmbajtja e rrugëve. Për tri vite në mirëmbajtjen e rrugëve janë shpenzuar mbi 22.000 euro, përderisa për mirëmbajtjen e automjeteve janë shpenzuar mbi 56.000 euro.

Nga buxheti i kësaj komune prej 9.984.328 euro për vitin 2013, pjesa më e madhe e tij shkon për paga e mëditje, afro 61% të totalit të buxhetit, pastaj vije fusha e investimeve kapitale me 27%, për mallra dhe shërbime dedikohen 9% e buxhetit, për shpenzime komunale 2% dhe për subvencione 1.5% e buxhetit.

Grafikoni nr.1: Buxheti i Komunës së Skenderajt 2013



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?skenderaj/2013#/~skenderaj>

Komuna e Skenderajt ka një numër të madh të familjeve të cilat i plotësojnë kushtet për të tërhequr ndihmën sociale. Në Prishtinë ku jetojnë mbi 198.000 banorë, gjatë vitit 2012 kanë tërhequr ndihmë sociale 2.659 familje.<sup>17</sup> Ndërsa në Komunën e Skenderajt me më pak se 51.000 banorë në të njëjtin vit (2012), numri i familjeve që kanë tërhequr ndihmën sociale është nga 1.700 deri në 1.400 familje. Nëse llogaritet shifra e anëtarëve të

<sup>17</sup>Bisedë me Drejtorinë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Prishtinës Valbon Krasniqin.

familjeve në Skenderaj të cilët jetojnë nën asistencën sociale me shifrën e përgjithshme të popullsisë në atë komunë, atëherë rezulton se afro 20% e popullatës në Komunën e Skenderajt janë pjesë e skemës sociale.

Tabela nr.7: Numri i familjeve që kanë tërhequr ndihme sociale në Komunën e Skenderajt gjatë vitit 2012 duke përfshirë numrin e anëtareve të familjeve

| 2012    | Numri i Familjeve | Numri i anëtareve të familjeve | Shuma (Euro) |
|---------|-------------------|--------------------------------|--------------|
| Janar   | 1.692             | 8.875                          | 118.413      |
| Shkurt  | 1.720             | 9.000                          | 120.248      |
| Mars    | 1.704             | 8.879                          | 119.030      |
| Prill   | 1.680             | 8.759                          | 117.660      |
| Maj     | 1.660             | 8.642                          | 115.895      |
| Qershor | 1.619             | 8.425                          | 113.645      |
| Korrik  | 1.602             | 8.283                          | 112.365      |
| Gusht   | 1.581             | 8.163                          | 110.160      |
| Shtator | 1.556             | 8.023                          | 108.595      |
| Tetor   | 1.338             | 6.775                          | 92.940       |
| Nëntor  | 1.459             | 7.428                          | 104.985      |
| Dhjetor | 1.478             | 7.496                          | 151.960      |

#### 4. Investimet kapitale

Investimet kapitale në Komunën e Skenderajt gjatë tri viteve të kaluara kanë pasur një shtrirje relativisht të gjerë veçmas në rregullimin e rrugëve, duke përfshirë rehabilitimin, asfaltimin dhe pjesërisht ndriçimin e tyre. Mbeten të pamjaftueshme investimet në rregullimin dhe instalimin e kanalizimeve si dhe shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit. Shuma e përgjithshme e mjeteve që ka në dispozicion Komuna e Skenderajt gjatë një viti për investime kapitale sillet afro 2.7 milionë euro.

Tabela nr. 8: Disa nga investimet kapitale të Komunës së Skenderajt 2010-2013<sup>18</sup>


| <b>Projektet kryesore të realizuara gjatë 2012</b>             | <b>Shuma (euro)</b> |
|--|---------------------|
| Ndërtimi i Kullës "Ilaz Kodra"                                 | 5.216               |
| Asfaltimi i rrugës Leqinë-Pemishtë                             | 68.247              |
| Rregullimi i lokaleve në stadiumin e qytetit                   | 35.481              |
| Asfaltimi i rrugës në lagjen "Mangjollli"                      | 55.000              |
| Ndërtimi i urës në Klina e Epërme                              | 3.000               |
| Rregullimi i parkut "Te pishat"                                | 7.814               |
| Asfaltimi i rrugëve në lagjet "Hasanaj", "Brega" dhe "Neziraj" | 35.000              |
| Asfaltimi i rrugës "Fadil Rustemi"                             | 35.000              |
| Asfaltimi i rrugës në Vojnikë                                  | 703.301             |
| Asfaltimi i rrugës në relacionin Turiqefc-Kopiliq              | 561.580             |
| Ndërtimi i objektit të Administratës Komunale (dy faza)        | 230.000             |
| <b>Projektet kryesore të realizuara gjatë 2011</b>             | <b>Shuma (euro)</b> |
| Infrastruktura në lagjen e dëshmorëve                          | 217.017             |
| Asfaltimi i rrugës në lagjën "Malaj"                           | 267.342             |
| Asfaltimi i rrugës në Mikushnicë                               | 330.000             |
| Asfaltimi i rrugës në lagjen "Binakaj"                         | 120.000             |
| Ujësjiellësi Prekaz-Dashefc                                    | 120.000             |
| Asfaltimi i rrugës në Kopiliq                                  | 40.000              |
| Asfaltimi i rrugës në Rakinicë                                 | 30.000              |
| Asfaltimi i rrugës në Kopiliq të Poshtëm                       | 120.000             |
| Asfaltimi i rrugëve në lagjet "Dajakaj" dhe "Durmishaj"        | 130.000             |
| Asfaltimi i rrugës në Klinë të Poshtme                         | 30.260.00           |
| Kompleksi i banesave në lagjen e dëshmorëve                    | 453.432             |
| Ndërtimi i murit mbrojtës në Kuçicë                            | 145.500             |
| Asfaltimi i rrugës "Mbretëresha Teutë"                         | 67.987              |
| Asfaltimi i rrugës Leqinë-Pemishtë                             | 10.428              |
| Ujësjiellësi në Prekaz   | 63.951              |
| Ndërtimi i banesave të dëshmorëve                              | 105.122             |
| <b>Projektet kryesore të realizuara gjatë 2010</b>             | <b>Shuma (euro)</b> |
| Rregullimi i rrugës "Miftar Bajraktari"                        | 82.000              |
| Rregullimi i rrugës "Abaz Thaçi"                               | 16.500              |
| Asfaltimi i rrugës Malaj-Rezallë                               | 83.324              |
| Ndërtimi i rrugës në fshatin Çubrel                            | 300.000             |
| Ndërtimi i kanalizimit fekale në Runikë                        | 21.325              |
| Asfaltimi i rrugës "Meto Bajraktari"                           | 20.000              |
| Rregullimi i rrugës "18 qershori"                              | 132.771             |
| Asfaltimi i rrugës "Abaz Thaçi"                                | 42.000              |
| Rregullimi i rrugës "Harun Beka"                               | 26.999              |
| Ndërtimi i shkallëve të stadiumit                              | 81.017              |

<sup>18</sup>Paraqitja e disa investimeve me vlera fikse në tabelën nr.11 nënkupton vetëm vlera të kontraktuar, jo domosdoshmërisht të shpenzuar në shumën e njëjtë. Shumat jo fikse janë të shpenzuara në përputhje me projektet e prezantuara në tabelë.

Gjatë tri viteve të fundit Komuna e Skenderajt, ka dështuar në realizimin e disa projekteve të mëdha ose ka zvarritur përfundimin e tyre. Kësisoj, projekti “Impianti” për pastrimin e ujërave të zeza në fshatin Llaushë ku janë investuar mbi 3 milion euro nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, edhe pse është përfunduar, nuk ishte lëshuar në përdorim për disa vite për shkak të një pengese të një banori nëpër pronën e të cilit kalojnë 70 metra gyp nëntokësor. Projekti tjetër, po ashtu milionësh, i trafostacionit elektrik në Skenderaj, ka ngecur me vite për shkak të pengesës së një pronari për vendosjen e një shtylle elektrike. Projekti i tretë ishte Parku i Biznesit, financim slloven, i cili ka dështuar plotësisht edhe pse tri herë janë organizuar ceremoni përrurimi të fillimit të punimeve. Zvarritje ka pasur edhe në realizimin e projektit të shkollës së mesme profesionale, financim 4 milionësh i Norvegjisë. Zvarritje ka pasur edhe në projektin e Ministrisë së Infrastrukturës në rrugën Vushtrri – Skenderaj, ku në fshatin Polac, një kilometër rrugë ka mbetur e paasfaltuar tash e mbi gjashtë vite për shkak të kontesteve pronësore.

Nga buxheti i Komunës së Skenderajt për 2013, 26.5% e buxhetit të është i destinuar për investime kapitale. Pjesa më e madhe e buxhetit të investimeve kapitale sërish do të shkoj në rrugë (1.3 milion apo 52.6% e buxhetit për investime kapitale), 24.17% infrastrukturë jo rrugore (kanalizim dhe ujësjellës), 10.85% në arsim, 0.45% në shëndetësi, 0.38% kulturë, etj.

Grafikoni nr.2: Investimet kapitale në Komunën e Skenderajt për vitin 2013<sup>19</sup>



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?skenderaj/2013#/~/skenderaj/shpenzimet-kapitale>

<sup>19</sup> Instituti për Studime të Avancuara – GAP. Si i shpenzon shteti parat tona. Komuna e Skenderajt.

Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?skenderaj/2013#/~/skenderaj/shpenzimet-kapitale>

Përgjatë këtyre viteve, Komuna e Skenderajt është ndihmuar shumë edhe nga niveli qendror sa i përket investimeve kapitale. Për shembull, nga Buxheti i Ministrisë së Infrastrukturës për vitin 2013, 1.497.352 euro janë paraparë të investohen në Komunën e Skenderajt. Skenderaj radhitet si komuna e katërt për nga shuma e investimeve të Ministrisë së Infrastrukturës nëpër komuna. Kurse radhitet e dyta në listën e investimeve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), ku këtë vit pritet të investohen 1.4 milion euro në Komunën e Skenderajt.

Tab. Nr.9: Investimet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ministrisë së Arsimit nëpër komuna 2013

| Investimet e Ministrisë së Infrastrukturës nëpër komuna 2013   | Investimet e Ministrisë së Arsimit nëpër komuna 2013   |
|--|--|
| ■ Pejë 2,729,821.00 €  | ■ Pejë 1,800,000.00 €  |
| ■ Prishtinë 2,039,215.00 €   | ■ Skenderaj 1,400,000.00 €   |
| ■ Podujevë 1,766,414.00 €  | ■ Gjilan 961,000.00 €  |
| ■ Skenderaj 1,497,352.00 €   | ■ Kaçanik 900,000.00 €   |
| ■ Ferizaj 1,475,493.00 €   | ■ Rahovec 840,000.00 €   |
| ■ Klinë 1,210,649.00 €   | ■ Ferizaj 815,000.00 €   |
| ■ Istog 1,203,830.00 €   | ■ Mitrovicë 796,000.00 €   |
| ■ Shtime 959,144.00 €  | ■ Suharekë 770,000.00 €  |
| ■ Deçan 650,000.00 €   | ■ Viti 750,000.00 €  |
| ■ Junik 611,000.00 €   | ■ Deçan 700,000.00 €   |
| ■ Suharekë 587,767.00 €  | ■ Shtime 665,000.00 €  |
| ■ Lipjan 565,075.00 €  | ■ Dragash 650,000.00 €   |
| ■ Rahovec 550,000.00 €   | ■ Prishtinë 650,000.00 €   |
| ■ Hani i Elezit 517,829.00 €   | ■ Podujevë 610,000.00 €  |
| ■ Prizren 455,963.00 €   | ■ Prizren 590,000.00 €   |
| ■ Kamenicë 380,000.00 €  | ■ Klinë 570,000.00 €   |
| ■ Dragash 349,025.00 €   | ■ Fushë-Kosovë 540,000.00 €  |
|  | ■ Lipjan 465,000.00 €  |
|  | ■ Istog 457,000.00 €   |
|  | ■ Vushtrri 420,000.00 €  |
| Burimi:<br><a href="http://www.institutigap.org/spendings/#/~buxheti-i-kosoves-2013---shpenzimet/rruge/ministria-e-infrastruktures-/shpenzimet-kapitale-----">http://www.institutigap.org/spendings/#/~buxheti-i-kosoves-2013---shpenzimet/rruge/ministria-e-infrastruktures-/shpenzimet-kapitale-----</a> | Burimi:<br><a href="http://www.institutigap.org/spendings/#/~buxheti-i-kosoves-2013---shpenzimet/arsim-dhe-shkence/ministria-e-arsimit--shkences-dhe-teknologjise/shpenzimet-kapitale-----">http://www.institutigap.org/spendings/#/~buxheti-i-kosoves-2013---shpenzimet/arsim-dhe-shkence/ministria-e-arsimit--shkences-dhe-teknologjise/shpenzimet-kapitale-----</a> |

## 5. Aktivitetet e Prokurimit Publik

Komuna e Skenderajt e ka të rregulluar fushën e prokurimit publik në nivel të zyrës, e cila sipas organogramit funksionin brenda Drejtorisë së Administratës. Kjo zyre ka

gjithsejtë katër persona të punësuar, ku njëri nga ta mban pozitën e Shefit të Zyrës së Prokurimit. Për tri vite (2010-2012) Komuna e Skenderajt ka lidhur 194 kontrata nëpërmjet procedurave të prokurimit publik, me një vlerë të kontratave afro 19 milionë euro.

Tabela nr.10: Kontratat e Prokurimit në Komunën e Skenderajt 2010 -2012

| Viti            | Nr. i kontratave | Vlera e kontratave (euro) |
|-----------------|------------------|---------------------------|
| 2010            | 80               | 7.129.771,27              |
| 2011            | 62               | 5.859.635,68              |
| 2012*           | 52               | 6.215.059,83              |
| <b>Gjithsej</b> | <b>194</b>       | <b>19.204.466,78</b>      |

\*Për vitin 2012 të dhënat përfshijnë vetëm njoftimet e KRPP-së

Gjatë viteve 2010 -2012, Komuna e Skenderajt ka qenë komuna ndaj të cilës më së paku janë adresuar ankesa nga ana e operatorëve privat në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Vetëm dy ankesa të tilla janë adresuar në OSHP në periudhën e tri viteve të fundit. Të dy këto ankesa janë zgjidhur nga ana e OSHP në favor të vendimeve të marra nga ana e Komunës së Skenderajt.<sup>20</sup>

Në mesin e kontratave të lidhura në vitin 2012 nga Zyra e Prokurimit e Komunës së Skenderajt, hasen edhe kontrata me shumë të konsiderueshme parash kundruall punëve të një dimensionit jo edhe aq të madh:<sup>21</sup>

- Riparimi i automjetit zyrtar "Golf V" në Komunën e Skenderajt, vlera 3.105 euro.
- Furnizimi me llap-top dhe kompjuterë për Komunën e Skenderajt, vlera 78.440 euro.
- Punimi i busteve për shkollat fillore "Ahmet Delija" në Skenderaj dhe "Shote Galica" në Runik, vlera 9.950 euro.
- Punimi i busteve në shkollën fillore "Ahmet Delija" në Prekaz, vlera 28.690 euro.

## 6. Administrata e Komunës së Skenderajt

Komuna e Skenderajt ka gjithsej 208 persona të punësuar në administratën komunale, duke përfshirë zjarrfikësit, të punësuarit në Qendrën për Punë Sociale dhe në institucionet kulturore të qytetit. Ndërsa së bashku me sektorin e arsimit, ku përfshihen të punësuarit në çerdhen e qytetit, në shkollat fillore dhe ato të mesme si dhe në sektorin e shëndetësisë, numri i të punësuarve në institucionet publike komunale është 1.302 persona.

<sup>20</sup>Organi Shqyrtues i Prokurimit. Komuna e Skenderajt. Vendimet. Vitet 2010. 2011. 2012. Burimi: <http://oshp.rks-gov.net/?cid=1,71>

<sup>21</sup>Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës së Skenderajt. Periudha janar – dhjetor 2012. Zyra e Prokurimit. Fq 24 -27.

Tabela nr.11: Numri i të punësuarve sipas sektorëve në Komunën e Skenderajt dhe vështrimi gjinor

| Sektorët                                    | Numri i të punësuarve | M          | F         |
|---|-----------------------|------------|-----------|
| Zyra e Kryetarit                            | 11                    | 7          | 4         |
| Drejtoria e Administratës                   | 46                    | 39         | 7         |
| Drejtoria e Financave, ekonomi dhe zhvillim | 28                    | 24         | 4         |
| Drejtoria për Shërbime publike              | 24                    | 23         | 1         |
| Zyra për Komunitete                         | 9                     | 6          | 3         |
| Drejtoria për Bujqësi                       | 13                    | 12         | 1         |
| Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër         | 14                    | 11         | 3         |
| Drejtoria e Urbanizimit                     | 8                     | 4          | 4         |
| Drejtoria e Shëndetësisë dhe QPS            | 27                    | 21         | 6         |
| Drejtoria e Arsimit                         | 9                     | 8          | 1         |
| Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport       | 19                    | 15         | 4         |
| <b>Gjithsej</b>                             | <b>208</b>            | <b>170</b> | <b>38</b> |

Komuna e Skenderajt përveç që asnjë Drejtori nga nëntë gjithsejtë, nuk udhëhiqen nga femrat, numri i përgjithshëm i femrave të punësuar në dikasteret e komunës del të jetë shumë i vogël. Kësisoj, nga 208 të punësuar si shërbyes civil, vetëm 38 prej tyre janë femra. Numri i femrave të punësuar është i vogël edhe në sistemin arsimor dhe atë shëndetësor të kësaj komune. Siç haset nga tabela e mësipërme, Komuna e Skenderajt është e vetmja në Kosovë e cila nuk ka Drejtori të Inspektionit. Çështjet e kësaj fushe mbulohen nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, brenda të cilës funksionojnë sektori i inspektionit të ndërtimeve, inspektionit sanitar, inspektionit të komunikacionit dhe inspektionit bujqësor.

## 7. Arsimi në Komunën e Skenderajt

Gjatë tri viteve të kaluara, Komuna e Skenderajt kryesisht i ka fokusuar investimet në shtrimin e rrugëve, ndërtimin dhe riparimin e shkollave. Investimet në sferën e arsimit gjatë kësaj periudhe kanë qenë të gjëra. Investimet në arsim përgjithësisht kanë qenë të mbështetura financiarisht nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Komuna e Skenderajt ka një çerdhe publike, 41 shkolla fillore dhe katër shkolla të mesme.



Tabela nr.12: Numri i fëmijëve dhe i personelit në çerdhen e Skenderajt dhe vështrimi gjinor

| Numri i fëmijëve | F  | M  | Numri i edukatoreve | F | M | Personeli ndihmës | F | M |
|------------------|----|----|---------------------|---|---|-------------------|---|---|
| 79               | 40 | 39 | 8                   | 8 | 0 | 7                 | 4 | 3 |

Tabela nr.13: Numri i mësimdhënëseve dhe stafit përcjellës në 41 shkollat fillore dhe katër shkolla të mesme të Skenderajt:

| Gjinia            | Shkolla fillore |               | Shkolla të mesme |               |
|-------------------|-----------------|---------------|------------------|---------------|
|                   | Mësimdhënës     | Stafi ndihmës | Mësimdhënës      | Stafi ndihmës |
| Femra             | 162             | 11            | 50               | 3             |
| Meshkuj           | 415             | 138           | 107              | 17            |
| <b>Gjithsejtë</b> | <b>577</b>      | <b>149</b>    | <b>157</b>       | <b>20</b>     |

Tabela nr.14: Numri total i mësimdhënësve, nxënësve dhe stafit ndihmës në 41 shkolla fillore dhe katër shkolla të mesme në Komunën e Skenderajt

| Kategoria     | Numri  | F     | M     |
|---------------|--------|-------|-------|
| Mësimdhënës   | 734    | 212   | 522   |
| Nxënës        | 13.381 | 6.299 | 7.082 |
| Stafi ndihmës | 169    | 14    | 155   |

Investimet në sferën e arsimit në Komunën e Skenderajt nuk kanë pasur planifikim të mirëfilltë. Në fshatrat Kastriot dhe Radishevë janë ndërtuar objekte shkollore të cilat qëndrojnë të mbyllura, me arsytimin e mungesës së nxënësve. Shkolla në fshatin Kastriot nuk është hapur asnjëherë, ndërsa ajo në fshatin Radishevë ka qenë e hapur tri vite radhazi, por pas kësaj periudhe është mbyllur. Po ashtu, në katër fshatra janë ndërtuar objekte të mëdha për numrin ekzistues të nxënësve që kanë. Në fshatin Turiqefc është në ndërtim një objekt i tillë edhe pse objekti ekzistues ishte i mjaftueshëm dhe ishte rinovuar para disa vitesh për çka ishin investuar rreth 250.000 euro. Edhe në fshatin Klinë e Epërme është duke u ndërtuar një i tillë edhe pse numri i nxënësve nuk mjafton as për një ndërrim mësimi. Ndërkaq, në fshatrat Prekaz i Epërm dhe Runik, tashmë janë lëshuar në përdorim objekte të njëjta me hapësira relativisht të mëdha në krahasim me numrin relativisht të vogël të nxënësve.

Tabela nr.15: Disa nga investimet në shkollat e Skenderajt gjatë periudhës 2010 -2012

| Investimet  | Shuma        |
|---|--------------|
| Furnizimi i shkollave me mjete mësimore për kabinete  | 22.816.      |
| Ndërtim i shkollës fillore në fshatin Rakinicë, Komuna Skenderaj                                  | 130.908      |
| Riparimi i shkollës fillore "Kuvendi i Drenicës" në Obri  | 13.400       |
| Rregullimi i shkollës fillore "Dëshmoret e Çiçavices" Dashevc                                     | 5.700        |
| Riparimi shkolla fillore "Bashkim Sadiku në Tushilë   | 9.854        |
| Shkolla fillore "Pavarësia" në Baks   |              |
| Riparimi i shkollës fillore "Dëshmoret e Çiçavices" paralelja në Qirez                            | 7.200        |
| Meremetimi i Shkollës fillore "Irir Lushtaku" në Prekaz   | 8.958        |
| Nyje sanitare në shkollën fillore "Malush Ahmeti në Rezallë                                       | 3.083        |
| Rregullimi i rrethojës në shkollën fillore "Drenica" në Polac                                     | 9.997        |
| Riparimi i shkollës fillore "Kuvendi i Drenicës " në Obri   | 3.996        |
| Hapja e kanalit për vendosjen e gypit të ujësjellësit në shkollën fillore "Shote Galica" në Runik | 3.582        |
| Furnizimi dhe montimi i kamerave në shkollën profesionale në Skenderaj                            | 7.052        |
| Furnizimi me pjesë të kaldajës të nxemjes qendrore në shkollën fillore "Fehmi Rama" në Likovc     | 2.610        |
| Ndërtimi i shkollës fillore "Shaban Jashari " në Skenderaj  | 2.090.650,40 |
| Rregullimi i brendshëm i shkollës "Ahmet Delija" në Skenderaj                                     | 12.669       |

## 8. Shëndetësia në Komunën e Skenderajt

Komuna e Skenderajt ka një shtrirje të kufizuar në mbulimin e territorit të saj me institucione të shëndetësisë primare. Skenderaj llogaritet t'i këtë 374 kilometër katror dhe në gjithë territorin funksionojnë pesë Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF), pesë ambulanca apo punkte shëndetësore si dhe në qendër të qytetit funksionon Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF). QMF dhe punktet shëndetësore gjenden të shpërndara nëpër fshatra, përkatësisht QMF-të janë në fshatin Prekaz i Epërm, Qirez, Likovc, Runik dhe në fshatin Turiqevc. Ndërsa punktet shëndetësore janë në fshatrat Polac, Llaushë, Rezallë, Aqarevë dhe Izbicë.

I gjithë rrjeti i shëndetësisë në Komunën e Skenderajt përbehet nga 176 të punësuar, prej tyre 32 mjek, pjesa tjetër infermier, staf administrativ dhe teknik. Në sektorin e shëndetësisë është i paraparë ofrimi i shërbimeve në pediatri, gjinekologji, radiologji, stomatologji. Qendra e stomatologjisë në QKMF ka disa vite që nuk ofron shërbimet e parapara dhe pacientet detyrohen t'u drejtohen ordinancave private.

Gjatë vitit 2012, Drejtoria e Shëndetësisë e Komunës së Skenderajt ka identifikuar problemet më të mëdha më të cilat aktualisht përballet sektori i shëndetësisë. Ato janë:

- Buxheti i pamjaftueshëm i Drejtorisë së Shëndetësisë,
- Mungesa e barërave dhe materialit shpenzues nga lista esenciale,
- Vështirësi në pagesat e kujdestarive, punës jashtë orarit, punës gjatë festave dhe punës së natës,
- Mungesë e hapësirave të nevojshme për zhvillimin e kujdesit emergjent,
- Mungesë të pajisjeve të nevojshme si dhe një kompanie profesionale që do të merrej me riparimet e nevojshme dhe në kohë,
- Prezencë e sëmundjeve ngjitëse sidomos në zonat rurale si pasojë e ndotjes së ujit të pijes,
- Mungesë të stafit që reflekton në pamundësi të realizimit të plotë të shumë shërbimeve (për arsye së një pjesë e stafit janë të moshuar dhe e paaftë t'i nënshtrohet ri trajnimeve të nevojshme), dhe
- Bashkëpunim jo i mjaftueshëm me Ministrinë e Shëndetësisë.

## 9. Transparenca e Komunës së Skenderajt

Komuna e Skenderajt, shikuar nga publikimet dhe azhurnimet në faqen zyrtare, qëndron më mirë se shumica e komunave tjera. Kjo mund të merret si faktor i përmirësimit të thellë të transparencës komunale dhe pasqyrimin të punëve komunale për opinion. Faqja zyrtare posedon materiale dhe informata të shumëllojshme për shumicën e sferave që mbulon Komuna. Njëherazi janë të publikuara edhe raportet financiare të këtij institucioni, si në lëminë e të hyrave ashtu edhe atë të shpenzimeve të parasë publike. Pasqyrimi i këtyre raporteve është bërë në mënyrë periodike, tre, gjatë, nëntë mujore dhe vjetore.

Tabela: nr.16: Vlerësimi i përmbajtjes së faqes zyrtare të Komunës së Skenderajt - <http://kk.rks-gov.net/skenderaj/>

| Dokumenti  | 2010 |    |     |    | 2011 |    |     |    | 2012 |    |     |    |
|--|------|----|-----|----|------|----|-----|----|------|----|-----|----|
|  | I    | II | III | IV | I    | II | III | IV | I    | II | III | IV |
| Raporti i Punës së Kryetarit                                 | x    | √  | x   | √  | x    | x  | x   | √  | x    | √  | x   | √  |
| Raporti financiar (buxhetor) i Komunës                       | x    | √  | x   | √  | x    | √  | x   | √  | x    | √  | x   | √  |
| Raportet e Drejtorisë së Administratës                       | x    | √  | x   | √  | √    | x  | x   | √  | √    | x  | √   | √  |
| Raportet e Drejtorisë së Arsimit                             | x    | x  | x   | √  | x    | x  | x   | √  | √    | x  | x   | √  |
| Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale | x    | x  | x   | √  | x    | x  | x   | √  | √    | x  | √   | √  |
| Drejtoria për Financa dhe Ekonomi                            | x    | √  | x   | √  | √    | x  | √   | x  | √    | x  | √   | √  |

|  |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |
|--|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër          | x | x | x | √ | x | x | x | √ | √ | x | x | √ |
| Drejtoria për Shërbime Publike               | x | x | x | √ | x | √ | x | √ | x | x | √ | x |
| Planifikim dhe Urbanizëm                     | x | x | x | √ | x | √ | x | √ | x | x | x | √ |
| Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport        | x | x | x | √ | x | √ | x | √ | √ | x | x | √ |
| Drejtoria e Bujqësisë                        | x | x | x | √ | x | √ | x | √ | √ | √ | x | √ |
| Zyra e Prokurimit                            | √ |   |   | √ |   |   | x |   |   |   |   |   |
| Raportet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm | x |   |   | x |   |   | x |   |   |   |   |   |
| Procesverbalet e Kuvendit Komunal            | x |   |   | x |   |   | x |   |   |   |   |   |
| Rregulloret Komunale                         | √ |   |   | √ |   |   | √ |   |   |   |   |   |
| Vendimet e Kuvendit Komunal                  | √ |   |   | √ |   |   | √ |   |   |   |   |   |
| Rregullorja e Punës së Kuvendit              | √ |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |
| Planet dhe Strategjitë e Komunës             | √ |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |   |

X = mungon raporti. √= raporti është i publikuar në ueb-faqe.

## 10. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009 kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z. Sami Lushtaku, para elektoratit të tij ka shpalosur premtime në sfera të ndryshme. Pas monitorimit të të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në fund të vitit 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës të cilit ia përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizimin e tyre.

Tabela e mëposhtme vlerëson progresin e arritur në realizimin e premtimeve të dhëna në vitin 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 33 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas tri viteve të qeverisjes në Komunën e Skenderajt, 15 premtime janë përmbushur, 11 tjera nuk janë përmbushur, ndërsa në 7 premtime ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por nuk mund të konsiderohen akoma premtime të përmbushura.

| Premtimet e 2009  | Realizimi 2010-2012   |
|---|---|
| Ndërtimi i pendës në zonën e quajtur Kuçicë, e cila do t'ua zgjidhë problemin e furnizimit me ujë të pijshëm për 200 mijë banorë. | Ky projekt është prezantuar nga ana e Komunës së Skenderajt dhe është kërkuar mbështetja e donatorëve. Nuk ka pasur ndonjë mbështetje për këtë projekt dhe si rrjedhojë planifikimi i Komunës së Skenderajt ka mbetur vetëm në letër. Ky premtim konsiderohet i pa përmbushur |
| Ndërtimi i Parkut Teknologjik, në të cilin do të punësoheshin 400-500 të rinj.  | Deri tani tri herë radhazi është inauguruar fillimi i punëve për ndërtimin e këtij parku, por punët në terren nuk kanë nisur asnjëherë, përveç prerjes së shiritave inaugurues dhe rrafshimit të terrenit. Ky premtim konsiderohet i pa përmbushur.                           |
| Ndërtimi i objektit banesorë, dedikuar kategorive të dala nga lufta.  | Ky premtim konsiderohet i përmbushur. Disa ndërtime janë bërë për këto kategori dhe po ashtu në qendër të qytetit është ndërtuar një ndërtesë për këtë kategori, ndërsa edhe dy të tjera janë në fazën e planifikimit. Ky projekt është mbështetur edhe                       |

|   |  |
|---|--|
|   | nga ana e MPMS.  |
| Funksionalizimin e ujësjellësit në fshatin Baks dhe Kopiliq që në fillim të vitit 2010. | Nuk është bërë. Premtim i pa përmbushur.   |
| Rregullimi i rrugës në fshatrat Açaravë dhe Prelofc.                                    | Premtim i përmbushur. Këto rrugë janë rregulluar gjatë vitit 2011.   |
| Ndërtimin e rrugës që lidh fshatrat Kllodernicë dhe Izbicë.                             | Ky premtim mund të konsiderohet si pjesërisht i përmbushur, ngase ka pasur investime në këto fshatra të cilat kanë ndikuar edhe në rrugën lidhëse mes këtyre dy fshatrave, por rruga qendrore që lidh këto fshatra në pjesën më të madhe është e pa rregulluar.  |
| Rregullimin e ujësjellësit dhe rrjetit elektrik në fshatrat e Komunës së Skenderajt.    | Rrjeti elektrik është përgjegjësi e KEK dhe kësaj premtim në këtë sferë nuk përkojnë me kompetencat e qeverisjes lokale. Pavarësisht kësaj, ky premtim mund të vlerësohet si pjesërisht i përmbushur ngase komuna nëpërmjet një donacioni të dhënë nga Agjencia për Rindërtim dhe Zhvillim (AER), i cili kishte paraparë riparimin e rrjetit elektrik për 26 fshatra, është realizuar në 11 sosh. Ndërkaq në rrjetin e ujësjellësit ka pasur disa investime, por mbeten të pamjaftueshme, ngase pjesa më e madhe e fshatrave të kësaj komune janë jashtë sistemit të ujësjellësit. |
| Ndërtimin e një ure që lidh lagjet Latifaj, Imeraj dhe Hajdaraj                         | Ky projekt është realizuar. Premtim i përmbushur.  |
| Rregullimin e rrugëve brenda fshatit Çubrel.  | Premtim i përmbushur. Rrugët në këtë fshat janë rregulluar dhe asfaltuar.  |

|  |  |
|--|--|
| Për fshatin Llaushë, furnizimi me ujë të pijshëm, rrjet kanalizimi dhe punësim për banorët.  | Premtim i pa përmbushur. Asnjë nga këto nuk janë realizuar.  |
| Për fshatrat e bashkësisë lokale të Runikut, ndërtimin e objektit shkollor, rregullimin e kanalizimit, investime në infrastrukturën rrugore. | Premtim i përmbushur. Shkolla është ndërtuar, ndërsa rrjeti i kanalizimit është instaluar në disa pjesë, akoma jo në tërësi.                                     |
| Për fshatin Makërmal, ndërtimin e shkollës dhe përmirësimin e rrjetin elektrik   | Premtim i pa përmbushur.   |
| Fshati Rezallë, renovimin e rrugës së dëmtuar.   | Premtim i përmbushur. Rrugët në këtë fshat janë përgjithësisht të rregulluara dhe të asfaltuara.   |
| Fshatrat Likofc dhe Plluzhinë, rregullimi i sistemit të kanalizimit dhe ujësjellësit.  | Premtim i pa përmbushur. Nuk ka pasur në këto dy fshatra investime të kësaj natyre.  |
| Për fshatin Klinë e Mesme, kanalizimin dhe përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit.   | Premtim i pa përmbushur. Nuk ka pasur në këto dy fshatra investime të kësaj natyre.  |
| Në fshatin Tërrnovë, ndërtimin e një rruge të gjatë 1.5 km, poligon sportiv dhe vendosjen e kontejnerëve.                                    | Premtim i përmbushur. Poligoni është ndërtuar, ndërsa investime ka pasur edhe në infrastrukturën rrugore.  |
| Në fshatin Radishevë, rrugë të asfaltuar, ujësjellës, rrymë, dhe rregullimin e poligonit sportiv të shkollës.                                | Vetëm rruga është rregulluar dhe asfaltuar, ndërsa në sfera të tjera nuk ka pasur investime. Premtim pjesërisht i përmbushur.                                    |
| Në fshatin Syriganë, asfaltimin e rrugës së fshatit për t'u lidhur me rrugën rajonale, kanalizim dhe ujësjellës.                             | Vetëm rruga është rregulluar dhe asfaltuar, ndërsa në sfera të tjera nuk ka pasur investime. Premtim pjesërisht i përmbushur.                                    |
| Në fshatin Vojnikë, ndërtimin e objektit të zyrës së vendit në Turiqefc dhe një ambulance për punktin shëndetësor në këtë fshat.             | I realizuar premtimi për ndërtimin e zyrës së vendit në Turiqefc (donacion i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal), premtimet të tjera të përcaktuara. |

|   |   |
|---|---|
| Në fshatin Kotorr sigurimin e transportit të nxënësve deri në Klinë të epërme, ujë të pijshëm në shkollën e fshatit dhe ndihmë sektorit të bujqësisë. | Premtim i pa përmbushur.  |
| Ndërtimin e ambulancës në fshatin Plluzhinë.  | Premtim i pa përmbushur.  |
| Ndërtimin e palestrës sportive në Skenderaj.  | Ky projekt ka nisur para më shumë se një viti dhe akoma nuk janë finalizuar punimet. Ky premtim mund të konsiderohet i përmbushur.  |
| Hapa konkret për zbutjen e papunësisë dhe zhdukjen e varfërisë.   | Komuna e Skenderajt është ndër komunat më të varfra në Kosovë, me shkallën më të lartë të papunësisë. Jo vetëm që nuk janë krijuar vende te reja të punës gjatë kësaj periudhe, por nuk është hartuar asnjë strategji rreth kësaj problematike.   |
| Realizimi i projektit të kanalizimit për fshatin Prekaz.  | I realizuar pjesërisht.   |
| Kushte më të favorshme për ushtrim të biznesit.   | Ky premtim mund të vlerësohet i përmbushur, ngase ka pasur vullnet të udhëheqjes komunale për t'u ndihmuar dhe lehtësuar biznesin. Komuna ka hequr taksën e regjistrimit të biznesit si dhe ka hapur një qendër adekuate për regjistrimin e tyre. |
| Renovim i Shtëpisë së Kulturës dhe menaxhim adekuat i saj.  | Premtim i përmbushur. Shtëpia e kulturës është rinovuar, ndërsa shkalla e menaxhimit të tij vlerësohet përgjithësisht i kënaqshëm.  |
| Bursa për studentë të dalluar.  | Premtim i përmbushur. Për çdo vit komuna ka dhënë bursa për student.  |
| Ndërtimin e aneksit të QKMF-së në Skenderaj.  | Premtim i pa përmbushur. Nuk ka pasur aneks të ri në QKMF.  |



|   |  |
|---|--|
| Ndërtimi i rrugës unazore në qytet.                             | Premtim i pa përmbushur.   |
| Kanalizim fekale në Runik, Prekaz, Klinë e Poshtme dhe Llaushë. | I realizuar për fshatrat Klinë e Poshtme dhe Runikë, ndërsa për fshatrat e tjerë jo. Pretim pjesërisht i përmbushur. |
| Ndërtimin e rrugës në fshatin Kryshefc.                         | Premtim i përmbushur.  |
| Ujësjetësin në Dashefc.   | Premtim i përmbushur.  |
| Ndërtimin e pullazit të shkollës në Izbicë.                     | Premtim i përmbushur.  |

## 11. Burimet:

1. Komuna e Skenderajt. Raporti i Punës së Kryetarit. Janar – dhjetor 2010. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/skenderaj/Municipality/President/Raportet-e-kryetarit/Raportet-2010.aspx>
2. Komuna e Skenderajt. Raporti i Punës së Kryetarit. Janar – dhjetor 2011. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/skenderaj/Municipality/President/Raportet-e-kryetarit/Raportet-2011.aspx>
3. Komuna e Skenderajt. Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim. Raporti i realizimit të buxhetit për vitin 2010. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/skenderaj/Municipality/Departments/Finance,-Economy-and-Development/Raportet/Raportet-2010.aspx>
4. Komuna e Skenderajt. Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim. Raporti vjetor i buxhetit komunal për vitin 2011. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/skenderaj/Municipality/Departments/Finance,-Economy-and-Development/Raportet/Raportet-2011.aspx>
5. Komuna e Skenderajt. Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim. Raportet e buxhetit për vitin 2012. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/skenderaj/Municipality/Departments/Finance,-Economy-and-Development/Raportet/Raportet-2012.aspx>
6. Komuna e Skenderajt. Drejtoria e Administratës. Raportet e vitit 2010 & 2011. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/skenderaj/Municipality/Departments/Administration-and-Personnel/Raportet.aspx>
7. Komuna e Skenderajt. Drejtoria e Arsimit. Lista e Punëtorëve në sferen e arsimit në Komunën e Skenderajt. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/skenderaj/Municipality/Departments/Drejtoria-per-Arsim/Raportet.aspx>
8. Komuna e Skenderajt. Lista e të punësuarëve në Administratën komunale. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/skenderaj/Municipality/Departments/Organogram.aspx>
9. Raportet vjetore të Koomisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - [http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCAnnual&PPRCMenu\\_OpenNode=90](http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCAnnual&PPRCMenu_OpenNode=90)
10. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Skenderajt. Burimi: [https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu\\_OpenNode=114](https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114)
11. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: [http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)
12. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L049\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf)

13. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Lista e rezultateve për zgjedhjet lokale të vitit 2009. Burimi: [http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/kryetar/rezultatetkk\\_raundi%202.pdf](http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/kryetar/rezultatetkk_raundi%202.pdf)
14. Ueb faqja zyrtare e Komunës së Skenderajt. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/skenderaj/>
15. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011. Burimi: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
16. Organi Shqyrtues i Prokurimit. Tabela me njoftimet e shpallura. Komuna e Skenderajt - 2011. Burimi: <http://oshp.rks-gov.net/?cid=1,71>
17. Televizioni “Kohavizion”. Emisioni “Rubikon”. Intervistë më Kryetarin e Komunës së Skenderajt Sami Lushtaku. Data: 26.06.2012. Burimi: <http://www.kohavision.net/video/rubikon/4322/>
18. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Ndarjen e kufijve Administrativ të Komunave. Nr.03/L-041. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L041\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L041_al.pdf)
19. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Ligji për Shkollimin Para Universitar në Republikën e Kosovës. Nr. 04/L-03. Burimi: [http://www.masht-gov.net/advCms/documents/1\\_Ligji\\_per\\_arsimin\\_Parauniversitar.pdf](http://www.masht-gov.net/advCms/documents/1_Ligji_per_arsimin_Parauniversitar.pdf)
20. Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Tabelat e Buxhetit të Kosovës për vitin 2011. Burimi: <http://mf.rks-gov.net/sqal/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxhetiqendror.e.aspx>
21. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Skenderajt për vitin 2011. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/Skenderaj\\_ALB\\_179857.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Skenderaj_ALB_179857.pdf)